

VENDIM
Nr. 890, datë 17.12.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 419, DATË 14.4.2011, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E AFATEVE DHE TË SKEMËS SË
SHPËRNDARJES SË FONDEVE TË DËMSPËRBLIMIT PËR ISH-TË DËNUARIT
POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pikat 6 dhe 8, të vendimit nr. 419, datë 14.4.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“6. Kësti pasardhës për të gjitha kategoritë përcaktohet me urdhër të ministrit të Financave, pas raportimit të drejtorisë përkatëse të dëmshpërblimit për ish-të përndjekurit politikë.”.

“8. Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministri i Financave, përpara mbylljes së vitit buxhetor, vlerësojnë procesin e realizimit të fondeve për të gjitha kategoritë dhe vendosin rialokimin e fondeve me urdhër të përbashkët.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama